



**BANKING AND PAYMENTS AUTHORITY OF KOSOVO**  
**AUTORITETI BANKAR DHE I PAGESAVE I KOSOVËS**  
**BANKARSKI I PLATNI AUTORITET KOSOVA**

Sipas dispozitave të Rregullores së UNMIK-ut 2005/20, mbi Pensionet në Kosovë, të datës së 29 Prill 2005, mbi ndryshimin e Rregullores së UNMIK-ut 2001/35 të datës 22 Dhjetor 2001,

Me qëllim të ekzekutimit të Nenit 8.4 (d); 8.5 dhe 8.6 të Rregullores së Pensioneve në lidhje me mirëmbajtjen e Llogarisë Individuale dhe dispozitat e gjendjeve të Llogarisë Individuale për pjesëmarrësit në rregullimet pensionale të Kontributeve të Definuara dhe të themelohet kërkesat tjera në mënyrë që të siguroj transparencën më të lartë në administrim dhe udhëheqje të pensioneve në veçanti të llojeve ku pjesëmarrësit bartin rrezikun e investimit sikur që është i ligjshëm në skemën e Pensioneve me Kontribute të Definuara.

Bordi Drejtues i Autoritetit Bankar të Pagesave të Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 16 Mars 2006 miraton si vijon:

## **Rregulla 7 mbi Ndryshimin e Rregullës mbi Sigurimin dhe mirëmbajtjen e Llogarisë Individuale të Pjesëmarrësit dhe Informata tjera relevante të Pensionit të dates 25 Korrik 2005**

**Neni**

**Sfera dhe qëllimi i rregullës**

### **1.1 Sfera e rregullës**

Kjo rregull i adresohet Trustit të Pensioneve të Kursimit të Kosovës (“Trusti”).

Kjo rregull poashtu i adresohet Fondit Suplementar Punëdhënës të Pensioneve (“Fondi I Pensionit”), dhe Siguruesit Suplementar Individual të Pensioneve (“Siguruesi I Pensioneve”) duke ofruar ose munduar të ofrojë Pensionet e Kontributeve të Definuara, dhe aty ku aplikohet, për siguruesit e pensioneve me Përfitim të Definuar.

### **1.2 Qëllimi i rregullës**

Kjo Rregull parashkruan kërkesat për mirëmbajtje përkatëse të Llogarive Individuale të pjesëmarrësve me Kontribute të Definuara. Poashtu qëllimi i kësaj Rregulle është që të themelohet direktivat që të sigurojnë transparencën për qështjet në lidhje me manovrimin me kontributet e pensioneve, administrimin dhe menagjmentin e mjeteve të pensionit, praktikat e investimeve dhe punët që aplikohen për të gjitha entitetet.

## **Neni 2**

### **Dispozitat e përgjithshme**

#### **2.1 Definimi**

Të gjitha kushtet e shfrytzuara në këtë rregull janë definuar dhe caktuar si në Rregulloren e Pensionit dhe/ose sikur që janë definuar në këtë Rregull.

“Principet e investimit” që i referohen politikës investuese dhe objektivave të zhvillimit të investimeve të përshtatura nga entiteti I pensionit për investimin e mjeteve të pensioneve qoftë të shprehura në Urdhëresat e Pensionit, Rregullat e Pensionit ose në direktivat e investimit të nxjerrura për Menagjerët e Mjeteve dhe/ose Kujdestarët.

“Direktivat Investuese” që i referohen urdhërave dhe udhëzimeve të bëra nga entiteti I pensionit për Menagjerin (et) e mjeteve dhe/ose Kujdestarët që specifikojnë termet, kushtet dhe mënyrën e investimit të mjeteve të pensioneve në pajtim me deklaratën e principeve të investimit.

“Interpretimi i investimeve” nënkupton fitimin ose profitin e realizuar, ose humbjen e shfaqur, në investimet e mjeteve të pensioneve. Kjo mund të shprehet si përqindje e pasurisë së investuar të pensionit ose e përcaktuar sipas shumës.

“Rreziku i investimit” i referohet ekspozimit të mjeteve të pensionit ndaj disa paqartësive gjatë zhvillimit të investimeve. Rreziku i investimit është prezent kur shkalla e të ardhurave nuk është fikse dhe e garantuar.

“Entiteti i Pensionit” përfshin, nëse konteksti nuk tregon ndryshe, Trustin, Fondin e Pensionit dhe Siguruesit e Pensionit.

“Ndryshimi i rëndësishëm në principet e investimit” shfaqet kur:

1. Politikat e investimit dhe objektivat janë ndryshuar, ose
2. Direktivat e rëndësishme të investimit për Menagjerin(et) e Mjeteve ose Kujdestarin është ndryshuar, ose
3. Ndryshimi në principet e investimit është konsideruar i rëndësishëm nga bordi drejtues i entitetit të pensionit ose BPK-s.

#### **2.2 Obligimet për Pjesëmarrësit e Pensioneve dhe Përfituesit**

Përveq obligimeve tjera të ofruara në Rregulloren e Pensionit, kjo Rregull, Urdhëresat e Pensionit ose Rregullat e Pensionit, entitetet e pensionit i detyrohen pjesëmarrësve dhe përfituesve me obligimet si vijojn:

- a) Mbajtja si duhet e shënimeve dhe kontabiliteti i kontributeve dhe të ardhurave të investimeve. Asnjë entitet i pensionit nuk mund të fillojë mbledhjen e kontributeve të pensioneve nëse nuk i ka sistemet adekuate të kontabilitetit si dhe mbajtjen adekuate të shënimeve që në mënyrë të përpikt të regjistroj kontributet e pensionit si dhe të jetë në gjendje të mbaj kontabilitetin e të ardhurave të investimeve dhe shpërndarjen e mjeteve të pensioneve në Llogarit Individuale të pjesmarrësve.
- b) Llogarit individuale. Qdo entitet i pensionit që ofron rregullim pensional të Kontributeve të Definuar duhet të ju siguroj pjesmarrësve raport mbi Llogarit Individuale.
- c) Raporti vjetor. Entitetet e pensionit janë të obliguara të ju japin në dispozicion të gjithë pjesmarrësve një raport vjetor.
- d) Informatat e pensionit. Qdo entitet i pensionit duhet të siguroj informatat e pjesmarrësve në lidhje me rregullimin pensional dhe investimet e mjeteve të pensioneve të kërkuara nga pjesmarrësi në pajtim me këtë Rregull.

### **Neni 3**

#### **Ekstrakti i Llogaris Individuale**

##### **3.1 Forma dhe përmbajtja**

Formati i ekstraktit të Llogaris Individuale që do të sigurohet pjesmarrësve do të përshtatet nga Trusti për pensionet e kursimit.

Formularët e ekstrakteve të Llogarive Individuale që shfrytëzohen nga Fondi I Pensionit dhe Siguruesi I Pensionit duhet të parashtrihen për aprovim në BPK para përdorimit të tyre.

Të gjitha ekstraktet e Llogarive Individuale duhet të përmbajnë minimumin e informatave si vijojn:

- a) Emri i plotë dhe adresa e Pjesmarrësit dhe numri korrespondues identifikues, nëse është i aplikueshëm.
- b) Emri i punëdhënësit kontribues ose punëdhënësi.
- c) Data “prej” (“as of”) ose “gjer më” (“cut-off”) për pranimin e kontributeve të pasqyruara në ekstrakt dhe data e aplikueshme e datës së vlersimit, nëse është ndryshe prej datës “gjer më”.

- d) Shuma e kontributeve që në mënyrë të duhur tregojnë kontributet e pjesëmarrësve dhe kontributet e dhëna nga pundhënësi ose punëdhënësit në emër të pjesëmarrësit.
- e) Shuma e të ardhurave të investimit ose humbja që është shtuar ose zbritur prej llogarisë (të ardhurat e shpërndara të investimeve).
- f) Bilanci i akumuluar i llogaris si e datës “gjer më”.
- g) BPK mundet koh pas kohe për interesin e pjesëmarrësit dhe përfituesit të kërkojë informata të tjera të nevojshme të përfshihen në ekstraktet e Llogarive Individuale të shfrytzuara nga Fondi i Pensionit dhe Siguruesit e Pensionit.

### **3.2 Koha brenda së cilës duhet të sigurohen raportet e Llogarive Individuale**

- a) Kërkesat e obligueshme. Raporti i Llogaris Individuale duhet të sigurohet në baza vjetore (një herë në qdo periudhë prej 12 muajve) gratis për pjesëmarrësit individual brenda 9 muajsh pas fundit të vitit fiskal të Trustitit .

Raportet e Llogarive Individuale për pjesëmarrësit e pensioneve suplementare mund të ndërprehen (“cut-off”) në qdo fund të muajit. Siguruesit e pensioneve suplementare duhet të sigurojnë raportet e Llogarive Individuale për pjesëmarrësit e tyre së pakun një herë në vit.

- b) Me kërkesën. Raportet e Llogaris Individuale në fund të qdo muaji të vlersimit duhet të sigurohen për qdo pjesëmarrës brenda 30 ditësh prej kërkesës së saj apo të tij. Për këtë qëllim, Entiteti I pensionit mund të ngarkoj me taksë që nuk e tejkalon qmimin e arsyeshëm për sigurimin e raportit të kërkuar.

## **Neni 4**

### **Informatat relevante të pensionit**

#### **4.1 Detyra për të siguruar informatat për pensionin**

Për të shfaqur një transparencë më të lartë në administrimin dhe menagjmentin e qdo rregullimi pensional, të gjitha entitetet e pensionit duhet të sigurojnë informatat që vijojnë për pjesëmarrësit e tyre:

##### **a) Kërkesat e obligueshme**

1. Për Pensionin Suplementar Pundhënës. Qdo Fond i Pensionit duhet të diskutojë Urdhresat e Pensionit me të gjithë nëpunësit e pranuar të pensionit para se të themelohet Fondi i Pensionit dhe më pjesëmarrësit e ri para regjistrimit të saj ose të tij, duke u siguruar që të gjithë pjesëmarrësit e pensionit kanë kuptim të qartë dhe adekuat për rregullimin pensional, menagjmentin dhe administrimin e pensionit,

investimin e mjeteve të pensioneve dhe rrezikun e investimit që bart pjesmarrësi. Një kopje e Urdhresës së Pensionit duhet ti jipet të gjithë pjesmarrësve menjëherë pas pjesmarrjes.

2. Për Pensionin Suplementar Individual. Qdo Sigurues I Pensionit duhet të diskutoj Rregullat e tyre të Pensionit me të gjithë aplikantët individual për pjesmarrje në pension duke siguruar që qdo pjesmarrës ka fituar njohuri të qarta dhe adekuate për rregullimin pensional dhe rrezikun e investimit që bart pjesmarrësi. Një kopje e Rregullës së Pensionit duhet ti jipet të gjithë pjesmarrësve menjëherë pas pjesmarrjes.
3. Raporti vjetor i trupit drejtues. Antarët e trupit drejtues të entiteteve të pensionit duhet të pregaditin një raport vjetor në fund të qdo viti financiar dhe të ju lë në dispozicion gjithë pjesmarrësve të tij nga një kopje të raportit vjetor para ose më 150 ditë pas fundit të vitit financiar. Raportet vjetore duhet së paku në minimum të përmbajnë informatat si vijojnë:
  - (i) Bëjë pasqyrim të menagjmentit të skemës së pensionit, statistikën e antarsis dhe zhvillimet gjatë vitit.
  - (ii) Shqyrtimin e politikës investuese dhe objektivat dhe zhvillimet aktuale të investimit.
  - (iii) Një përmbledhje të Raportit Vjetor Financiar të Revizionuar.
  - (iv) Raport ose qertifikat të ekspertit të pavarur në rastin e rregullimit pensional me Benefit të Definuar.
  - (v) Raportin që shpreh nivelin e përshtatshmëris për kërkesat e paraqitura të ligjit të aplikueshëm dhe/ose rregullat dhe e caktuara në Urdhëresë të Pensionit ose Rregulla të Pensionit, varsisht prej rastit.
4. E përgjithsme për të gjitha Entitetet e Pensionit. Qdo entitet I pensionit duhet ti siguroj përpjesmarrësit te tij:
  - (i) Informatat lidhur me ndonjë ligj, rregullore ose rregull, lidhur por jo kufizuar për taksimin dhe legjislacionin social dhe të punës që ekziston në atë kohë, ose që janë dekretuar gjatë pjesmarrjes së tyre që mund të ndikoj në të drejtat dhe obligimet e tyre në lidhje me pensionet e tyre; Brenda 60

ditësh pas njohtimit të tyre me një ligj të till, rregullore ose rregull.

- (ii) Ndryshimi signifikant ose ndryshimet në Politikën Investuese; Brenda 30 ditësh të asaj date ndryshimi bëhet efektiv.
  - (iii) Ndryshimet e Urdhëresës së Pensionit dhe/ose Rregullat e Pensionit; Brenda 30 ditësh prej datës kur ndryshimi hyn në fuqi.
- b) Me kërkesën. Qdo entitet i pensionit duhet të siguroj, në lidhje me të drejtat për të ngarkuar me taksa me qmim jo më të lartë se sa qmimi I arsyeshëm aktual, informatat që vijnë brenda 15 ditësh sipas kërkesës së pjesmarrësit të tij:
- (i) Një kopje të Raportit(ve) Financiar Vjetor të Revizionuar.
  - (ii) Nivelin e benefiteve në rast të përfundimit të punimit.
  - (iii) Shkallën e mundësive investuese, performancën aktuale të portofolios dhe të ardhurat cak të investimit.
  - (iv) Ekspozimi ndaj rrezikut, masat e rrezikut të investimit dhe proceset e rrezikut të menagjmentit të aplikuar, taksat dhe shpenzimet lidhur me investimet e mjeteve të pensionit.
  - (v) Benefiti i vlersuar i pensionimit dhe optionet e ndryshme të pagesave të pensionit për pjesmarrsit që priten të pensionohen më herët ose brenda 2 vitesh.
  - (vi) Informatat tjera relevante mbi pensionet që mund të priten që të jenë në dispozicion prej shënimeve të mbajtura nga Entiteti I Pensionit.

## **Neni 5**

### **Hyrja në fuqi**

Kjo rregull si e ndryshuar do të hyj në fuqi më 01 Prill 2006

Michel Svetchine  
Drejtori i përgjithshëm

